



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL¹

(I përmbledhur)

Tiranë, më 14.05.2019, ora 17.00

**Drejton mbledhjen -
Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit**

Rendi i Ditës :

- 1- Shqyrtimi i rasteve të kandidatëve të tërhequr nga kandidimi, për vendet vakante për Gjykatën Kushtetuese.*
- 2. Shqyrtimi i rasteve për gjetjet e deritanishme, në procedurën e verifikimit të disa prej kandidatëve për vendet vakante për Gjykatën Kushtetuese dhe atë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*

Marrin pjesë² :

- | | |
|---------------------|-----------|
| 1. Ardian Dvorani | (kryetar) |
| 2. Arta Marku | (anëtare) |
| 3. Fatri Islamaj | (anëtar) |
| 4. Margarita Buhali | (anëtare) |
| 5. Eriol Roshi | (anëtar) |

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike qëndrimet dhe diskutimet e plota të vetë anëtarëve të KED, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

² Anëtarja e Fatjona Memçaj nuk merr pjesë në diskutimin dhe miratimin e akteve nënligjore normative, për shkak të papajtueshmërisë-marrëdhënie krushqie e afërt me kandidaten Ardita Alsula. Sipas ligjit, Kryetari i Këshillit e ka miratuar heqjen dorë me vendimin nr.1 datë 14.02.2019. Për rrjedhojë edhe në shqyrtimin e rasteve të kësaj kandidateje ose atyre që kandidojnë së bashku me të.,

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme:

1. *Erinda Ballanca*, Avokate e Popullit si dhe *Enio Haxhimihali* nga Institucioni i Avokatit të Popullit

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016 :

1. *Bledar Dervishaj*, përfaqësues i Presidentit të Republikës.

HAPET MBLEDHJA

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, informon se në mbledhje nuk merr pjesë anëtarja dhe zëvendëskryetarja e Këshillit, zonja Vitore Tusha, e cila, sipas njoftimit, e ka të pamundur pjesëmarrjen për shkak të një angazhimi të programuar kohë më parë dhe të rëndësishëm jashtë vendit.

Po kështu, edhe anëtarja Fatjona Memçaj nuk merr pjesë në mbledhjen e sotme për shkak se një nga rastet e shqyrtimit të ditës së sotme është një njeriu i afërt i familjes së saj, ndërkohë që motivet për të cilët ne do shqyrtojmë atë rast janë pothuajse të ngjashme me ato të rasteve të kandidatëve të tjerë. Në këtë mënyre për të mos ndikuar në këto rrethana procesin, ajo e deklaroi që nuk do marrë pjesë në mbledhje.

Ardian Dvorani lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

Shqyrtimi i rasteve të kandidatëve të tërhequr nga kandidimi, për vendet vakante për Gjykatën Kushtetuese.

Shqyrtimi i rasteve për gjetjet e deritanishme, në procedurën e verifikimit të disa prej kandidatëve për vendet vakante për Gjykatën Kushtetuese dhe atë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

Anëtarët e Këshillit miratojnë rendin e ditës së programuar.

Këshilli vijon mbledhjen me shqyrtimin e rasteve të kandidatëve të tërhequr nga kandidimet dhe gjetjet për disa kandidatë të tjerë për vendet vakante për Gjykatën Kushtetuese, duke filluar me rastin e parë, kandidimi të kandidatit Alban Brati.

Ardian Dvorani i kërkon anëtarit relator Fatri Islamaj të relatojë gjetjet për këtë rast kandidimi.

Fatri Islamaj parashtron relatimin për kandidatin Alban Brati për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti në datën 4.3.2019.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca, sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature parashtron se sipas të dhënave të relacionit të paraqitur dhe dokumenteve të vëna në dispozicion në mbledhjen e Këshillit, nuk konstatoj parregullsi në procedurat e ndjekura deri tani për verifikimin e kandidaturës. Gjithashtu, edhe vullneti i kandidatit për tërheqje nga kandidimet është i qartë dhe i shprehur rregullisht.

Ardian Dvorani i kërkon anëtarit relator Fatri Islamaj të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatës Irena Reso.

Fatri Islamaj, parashtron relatimin për kandidaten Irena Reso për vendin vakant për gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti në datën 4.3.2019.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca, sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature parashtron se nuk kam asnjë koment tjetër të ndryshëm. Kam të njëjtin qëndrim si në rastin më parë.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatore Arta Marku të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Theodhori Sollaku.

Arta Marku, parashtron relatimin për kandidatin Theodhori Sollaku për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti me datë 07.02.2018.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shtron pyetjen se mos ka pasur ndonjë lloj vendimmarrje në këtë rast, për sa kohë që Këshilli deri me tani ka marrë vendime në lidhje me dorëheqjet, le të themi shtysë për vendimmarrje në ndonjë mënyrë për të. Nëse po Këshilli mund t'ia kishte dhënë mundësinë ndaj e pyes a ka patur një kopje relacionit të dërguar për këtë shqyrtim.

Arta Marku sqaron dijeninë e rregullt të kandidatit për procesin e zhvilluar deri më tani, për relacionin dhe për shqyrtimin e rasteve të tij në mbledhjen e sotme.

Erinda Ballanca merr fjalën dhe shprehet se atëherë, kam të njëjtin qëndrim si në rastet e mëparshme.

Ardian Dvorani relatton rastin tjetër të kandidimit të kandidatit Theodhori Sollaku për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Kuvendi në datën 28.08.2018.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se kam të njëjtin qëndrim si në rastet më parë.

Ardian Dvorani relatton rastin tjetër të kandidimit të kandidatit Theodhori Sollaku për vendin vakant, vakancë e parakohshme, për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 24.12.2012.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se kam të njëjtin qëndrim si në rastet më parë.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatores Margarita Buhali të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Genci Islamili.

Margarita Buhali parashtron relatimin për kandidatin Genci Ismaili, për vendin vakant për Inspektor i Lartë të Drejtësisë.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se sipas të dhënave të relacionit të paraqitur dhe dokumenteve të vëna në dispozicion në mbledhjen e Këshillit, nuk konstatoj parregullsi në procedurat e ndjekura deri tani për verifikimin e kandidaturës. Gjithashtu, edhe vullneti i kandidati për tërheqje nga kandidimi është i qartë dhe i shprehur rregullisht.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatores Arta Marku të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Avni Shehu.

Arta Marku, parashtron relatimin për kandidatin Avni Shehu për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur me date 07.02.2018 nga Presidenti i Republikës.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se sipas të dhënave të relacionit të paraqitur dhe dokumenteve të vëna në dispozicion në mbledhjen e Këshillit, nuk konstatoj parregullsi në procedurat e ndjekura deri tani për verifikimin e kandidaturës. Lidhur me qëndrimin e kandidatit për afatin e dorëzimit të Deklaratës së Pasurisë, Avokati i Popullit konstaton se ndonëse afati është shumë i shkurtër, ai është një afat i caktuar në nenin 235, pika 2 e Ligjit 115/2016. Në lidhje me kërkesën e bërë për të shtyrë me 30 ditë afatin e paraqitjes së deklaratës, Avokati i Popullit nuk gjen ndonjë mundësi për ta pranuar për shkak se një gjë e tillë nuk rezulton në kompetencë të Këshillit. Vullneti alternativ i kandidati për tërheqje nga kandidimi nëse nuk ka vend për shtyrje afatesh është i qartë dhe i shprehur rregullisht.

Ardian Dvorani i kërkon anëtarit relator Fatri Islamaj të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Avni Shehu.

Fatri Islamaj, parashtron relatimin për kandidatin Avni Shehu për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur me date 04.03.2019 nga Presidenti i Republikës.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se kam të njëjtin qëndrim, si në rastin më parë.

Ardian Dvorani relaton rastin tjetër të kandidimit të kandidatit Avni Shehu për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 24.12.2018.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se kam të njëjtin qëndrim, si në rastin më parë.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatores Arta Marku të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidates Ardita Alsula.

Arta Marku, parashtron relatimin për kandidaten Ardita Alsula për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur me date 07.02.2018 nga Presidenti i Republikës.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se pretendimi i zonjës është që sipas saj data 26 është data e fundit e afatit. Por, ndërkohe, po të fillonte me numërimin nga e nesërmja e datës që ka marrë njoftimin, do i binte data 25. Pra, e ka humbur afatin për 1 ditë.

Largohet Avokati i Popullit znj. Erinda Ballanca. Në vend të saj, prezent në sallë është përfaqësuesi i saj nga institucioni i Avokatit të Popullit, z. **Enio Haxhimihali**.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatores Arta Marku të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Denar Biba.

Arta Marku, parashtron relatimin për kandidatin Denar Biba për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur me datë 07.02.2018 nga Presidenti i Republikës.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Enio Haxhimihali, sipas procedurës për dhënien e mendimit nga Avokati i Popullit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se kemi të njëjtin qëndrim me rastet e tjera.

Ardian Dvorani i kërkon anëtarit relator Eriol Roshi të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Denar Biba.

Eriol Roshi, parashtron relatimin për kandidatin Denar Biba për vendin vakant plotësues për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Enio Haxhimihali, sipas procedurës për dhënien e mendimit nga Avokati i Popullit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se nuk kam komente ndryshe nga rastet e tjera.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatores Arta Marku të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Kristaq Traja.

Arta Marku, parashtron relatimin për kandidatin Kristaq Traja për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Enio Haxhimihali, sipas procedurës për dhënien e mendimit nga Avokati i Popullit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se nuk kam komente të tjera veç atyre të paraqitura.

Ardian Dvorani relaton rastin tjetër të kandidimit të kandidatit Vasil Bendo për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 28.08.2018.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Enio Haxhimihali, sipas procedurës për dhënien e mendimit nga Avokati i Popullit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se nuk kam komente tjera ndryshe nga rastet e mëparshme.

Ardian Dvorani i kërkon anëtarit relator Fatri Islamaj të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Kostandin Kazanxhi.

Fatri Islamaj, parashtroi relatimin për kandidatin Kostandin Kazanxhi për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 04.03.2019.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Enio Haxhimihali, sipas procedurës për dhënien e mendimit nga Avokati i Popullit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se nuk kam komente të tjera.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, pasi evidenton që këto ishin çështjet e programuara për shqyrtim në rendin e ditës dhe deklaroi mbylljen e mbledhjes.

MBLEDHJA MBYLLET NË ORËN 18.17

Sekretare

Dorina DULAJ

Kryetari

Ardian DVORANI